



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:099975

Datë: 08.08.2025

Numri i dokumentit: 07612274

C.nr.2024:032499

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PERGJITSHËM-DIVIZIONI CIVIL, me gjyqtaren Kreshnike Zymberi Beqiri, me asistimin e bashkëpunëtorit profesional Gent Mustafa, në çështjen juridike kontestimore të paditësit K. Sh., të cilin me autorizim e përfaqëson avokati Liman Musa nga Ferizaj, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme – Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, për shkak të kompensimit të të ardhurave personale, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor të çështjes me datën 7 korrik 2025 në prani të paditësit dhe të autorizuarit të tij dhe në mungesë të përfaqësuesit së të paditurës, mori ndërsa me datën 08 gusht 2025 perpiloj me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit K. Sh. nga F., e paraqitur kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme – Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, ashtu që;
- II. DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme – Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, që paditësit në emër të kompensimit nga të ardhurat personale t'ia paguajë diferencën në pagë në shumën e përgjithshme prej 1,824.⁶⁴(një mijë e tetëqind e njëzetë e katër euro e gjashtëdhjetë e katër cent) dhe atë për punën shtesë si Udhëheqës i njësisë reaguese në periudhën kohore nga data 04.03.2016 deri më datën 01.11.2018, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë (13.06.2018), e deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 865.⁰⁰€, të gjitha këto brenda afatit 7 ditor pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

1. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse:

Paditësi K. Sh., përmes të autorizuarit të tij, pranë kësaj gjykate, me datën 13.06.2018, ka parashtruar padi kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme – Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, për kompensimin e të ardhurave personale.

Në padi është theksuar se paditësi K. Sh. është në një marrëdhënie pune me të paditurën dhe ka gradën – Rreshter, por krahas pozitës së tij, me vendim është i përcaktuar të kryej detyrën në Stacionin Policor në Ferizaj në detyrën e Udhëheqësit të Ndërrimit në njësinë reaguese e cila pozitë parashihet me gradën e Togërit. Ai këtë punë e ka kryer prej datës 04.03.2016 deri me datën 01.11.2018, përkatësisht dy vite e gjysmë, e për të cilën punë është dashur që të paguhet me gradën e Togërit mirëpo edhe përkundër faktit se e ka ushtruar këtë detyrë, ai nuk është paguar nga ana e të paditurës.

Më tej ka shtuar se e paditura duhet ta kompensoj paditësin për periudhën sa paditësi e ka kryer detyrën e ushtruesit të Togërit konform udhëzimit administrativ 04/2017 neni 36 pika 6, ku thuhet se ushtruesi i detyrës gëzon të gjitha të drejtat dhe beneficionet që i kanë takuar të punësuarit i cili me herët ka qënë në atë pozitë të Togërit, sa i përket ankesës së pafatshme që është thirrur e paditura nuk qëndron për shkak se po atë ditë kur ju ka refuzuar kërkesa paditësit e ka vazhduar punën edhe për 20 muaj duke kryer atë detyrë si udhëheqës ndërrimi-pozita e Togërit. Po ashtu paditësi K. Sh. e ka vazhduar ta kryej punën e Togërit në nderimin e pasdites me çka u vërtetuar se nuk e kanë humbur afatin e ankesës si dhe gëzimin e të drejtës së beneficionit apo diferencën në pagë sipas gradës me përshkrim në vendin e punës në Stacionin e Policisë në Ferizaj ku kanë qënë 4 Togëra të paraparë kurse në momenti kur ka punuar paditësi ka qënë ushtrues i detyrës me qëllim të plotësimit të vakumin i cili ka mbetur vetëm dy Togëra që kanë qënë në pozitë, caktimi në këtë pozitë është vendos nga menagjmenti ku e ka kryer këtë punë me përpikëri deri në momentin e fundit.

Andaj, mbi bazën e të lartcekurave ka kërkuar që kërkesëpadija e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar, duke e specifikuar sipas ekspertizës financiare dhe atë që paditësit t’ia paguajë diferencën në pagë në shumën e përgjithshme prej 1,824.⁶⁴, për periudhën kohore nga data 04.03.2016 deri më datën 01.11.2018, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë (22.06.2020), e deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 865.⁰⁰€,

E paditura përmes përgjigjes në padi e ka kontestuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se paditësi me asnjë dëshmi apo provë nuk ka arritur të argumentoj pretendimin e tij të paraqitur në kërkesëpadi. Ka vazhduar duke kërkuar nga gjykata që pas administrimit të gjitha provave të dorëzuar që gjenden në shkresat e lëndës të refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar dhe të lë në fuqi vendimin me nr. të lëndës i të paditurës MPB – Policisë së Kosovës. Përfaqësuesja e të paditurës ka shtuar se e paditura me vendimin numër të datë 04.05.2018 për çështjen juridike kompensim në pagë duke vepruar në pajtim me nenin 44 par. 2 të ligjit për Policinë e Kosovës dhe nenin 93 të Udhëzimit Administrativ numër 04/2017 për marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës ka hedh poshtë ankesën e paditësit e cila është parashtrua jashtë afatit ligjor sipas shkresave të lëndës Komandati i Stacionit Policor në Ferizaj me datë 19.06.2017 ka njoftuar paditësin për përgjigjeje e marra nga Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës për “*anulimin e aprovimit*” lidhur me kërkesën për emërim në pozita të adresuar nga Drejtoria Rajonale e Policisë në Ferizaj ku paditësi me datë 19.06.2017 ka qenë i informuar lidhur me anulimin e kërkesës në atë pozitë numër referencës datë 05.06.2017 nga Drejtori i Përgjithshme i Policisë së Kosovës ndërsa paditësi ankesën në Komisioni e Ankesave e ka parashtruar me datë 17.04.2018 numër referencës që nënkupton se është paraqitur jashtë afatit të paraparë Ligjor ku në nenin 93 para 3 pika 1.2 të Udhëzimit Administrativ numër 04-2017 përcakton se Personeli i Policisë i cili konsideron se me vendimin Administrativ i është shkelur ndonjë e drejta nga marrëdhënia e punës ka të drejt ankese në organin e shkallës së dytë e cila i dërgohet drejtpërdrejt Komisionit për Ankesa apo përmes Zingjirit Komandues brenda afatit 15 ditësh. Pretendimet e paditësit nuk qëndrojnë për faktin se e paditura ka vepruar konform dispozitave ligjore në fuqi ka shqyrtuar ankesën dhe ka marr vendim të drejt dhe të ligjshëm dhe se ka përmbushur detyrimin e saj ndaj paditësit.

Përfaqësuesi i të paditurës pas kthimit të lëndës në rigjykim dhe rivendosje, nuk ka marrë pjesë në seanca edhe përkundër thirrjeve të vazhdueshme të gjykatës, andaj Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, duke u bazuar në nenin 423 par 1, 2 dhe 4 të LPK-së ku parashihet se “*Gjyqtari i çështjes e deklaroi hapjen e seancës si dhe objektin e shqyrtimit. Pas kësaj gjykata verifikoi paraqitjen e të ftuarve dhe heton shkaqet e mosparaqitjes në seancë si dhe rregullsinë e thirrjeve të atyre që nuk kanë ardhur. Po që se në seancën për shqyrtim kryesor nuk vjen i padituri që është thirrur rregullisht, atëherë shqyrtimi kryesor i çështjes bëhet pa praninë e tij.*”

2. Provat e administruara;

Gjykata me qellim të vërtetimit sa më të drejtë të gjendjes së fakteve të çështjes për aq sa palët ndërgjyqëse përmbushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar ato, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së, ka administruar një sër provash: *Vendimi i Komisionit për ankesa i policisë së Kosovës i datës 04.05.2018, me numër, dokumenti me titull orari pune-qarkullues SP-Ferizaj, për muajin Maj 2018, e datës 31.05.2018, dokumenti me titull orari pune-qarkullues SP-Ferizaj, për periudhën nga data 01 janar 2017 deri maj 2018, dhe periudha nga data 05.09.2016 deri me 27.11.2016, Vendim i datës 11.10.2018, me numër, Email i drejtuar nga F. A. tek D. D. i datës 10.10.2018, se bashku me email te tjera, Vendimi i datës 03.03.2016, me numër, Dokument me titull propozime te pranuar nga departamenti i hetimeve etj, i datës 02.03.2016, me numër, i nxjerr nga e paditura, Email i drejtuar nga V. B. tek D. D. i datës 01.03.2016, me titull “Lista për caktim ne pozitë e rreshter”, se bashku me emaile te tjera dhe listën e personelit, Ankesë e datës 17.04.2018 e drejtuar nga paditësi tek e paditura, Memorandum zyrtar i datës 12.09.2018, me titull “propozim për sistemim te zyrtareve ne grada dhe rreshter”, Lista e pagave, për pozitën toger, për periudhën 2016, 2017, 2018 dhe 2019, së bashku me listën e personelit, përgjigje e datës 21.08.2024, e paraqitur nga majori i Stacioni Policor në Ferizaj dhe në fund Ekspertiza financiare e datës 07.04.2025, e hartuar nga eksperti Emin Plakaj.*

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është tërësisht e bazuar.

3. Gjendja faktike e vërtetuar:

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese ekzistimi i marrëdhënies së punës në mes paditësit dhe të paditurës përkatësisht paditësi është i caktuar në gradën Rreshter në Stacionin Policor në Ferizaj, por kontestuese nga e paditura është fakti se paditësit nuk i takojnë të ardhurat personale për punën e kryer në pozitën e ushtruesit të Togerit për të cilën kishte punuar nga data 01.06.2016 e deri më datë 01.11.2018.

Nga analizimi i Vendimit të Komisionit të Stacionit Policorë në Ferizaj i evidentuar me datën 19.06.2017, gjykata ka konstatuar fakti se ky Komision se ka njoftuar ankuesin Rreshterin K. Sh. (këtu si paditës) me përgjigjen e marrë nga Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës për “Anulimin e Aprovimit” lidhur me kërkesën për emërimin në pozitën të adresuar nga Drejtoria Rajonale e Policisë me nr..... datë 05.06.2017.

Paditësi K. Sh., vendimin me nr. të datë 04.05.2018 e kishte pranuar me datë 14.05.2018 ndërsa padinë e kishte paraqitur me datë 13.06.2018, në afatin ligjor si e ka udhëzuar pala e paditur me vendimin nr. të datë 04.05.2018.

Gjykata nga analizimi i Vendimit të evidentuar me numër të datë 04.05.2018, me të cilin vendim Komisioni për Ankesa i Policisë së Kosovës, e ka hedhur poshtë ankesën e parashtruar pasi e njëjta sipas Komisionit ishte parashtruar jashtë afatit ligjor nga ankuesi (këtu paditës) Rreshter K. Sh..

Nga analizimi i Memorandumit Zyrtar të datës 12.09.2018 vërtetohet Lista e Rreshterëve të propozuara për Sistemim-DRP Ferizaj, në të cilën paditësi K. Sh. renditet me numër 6. Ndërsa nga vendimi i evidentuar me nr., vërtetohet rrethana se paditësi K. Sh. është sistemuar në kohë të pa caktuar në pozitën e Rreshterit dhe atë nga data 12.10.2018.

Nga memorandumi i datës 02/03/2016 me Propozime e pranuar nga Departamenti i Hetimeve Operativës Kufirit dhe Burimeve Njerëzore për Caktimin dhe Emërimin në Pozita të zyrtarëve policorë të cilët do t'i promovohen në gradën Rreshter, Pozitat e verifikuara nga Drejtoria e Personelit me LPA Listën e emërimit të pozitave për personelin e uniformuar me nr..... KP është renditur me nr. ... K. Sh..

Nga lista për caktimin në pozitat Rreshter, paditësi K. Sh. është i renditur me numrin me në pozitën e Mbikëqyrësit të Sektorit Policor.

Meqenëse ka qenë kontestuese se me cilin vendim është caktuar paditësi që të ushtroj drejtat dhe detyrimet në pozitën e Togërit gjatë periudhës 01.06.2016 e deri me datën 01.11.2018, gjykata ka aprovuar propozimin e të autorizuarit të paditësit që gjykata t'i drejtohet në mënyrë zyrtare të paditurës që të marrë informacione lidhur me këtë çështje.

Nga Përgjigja e Policisë së Kosovës - Stacionit Policor në Ferizaj, nga ana e Majorit Q. R., e datës 21.08.2024, ku i njëjti thekson se gjatë periudhës 01.06.2016 e deri me datën 01.11.2018 kishte qenë Komandant i Stacionit Policor në Ferizaj dhe ka deklaruar se paditësi K. Sh. ka shërbyer si Rreshter – Shef i ndërrimit patrullues në këtë Stacion. Lidhur me pyetjet e parashtruara nga ana e Gjykatës, Majori në këtë shkresë thekson se K. Sh. si Rreshter ka qenë i caktuar me vendim

shef i ndërrimit të njësisë reaguese ndërsa pozita ka qenë për gradë Togër, për shkak të mungesës së gradave ka kryer edhe detyrat e pozitës së Togërit. Detyrat dhe përgjegjësitë që ka kryer gjatë kësaj periudhe kanë qenë të Togërit, në mungesë të ushtruar nga Rreshteri. Në këtë pozitë kishte qëndruar nga data 01.06.2016 e deri me datën 01.11.2018.

Gjykata ka aprovuar propozimin e paditësit për caktimin e ekspertizës financiare në mënyrë që të bëhet llogaritja e diferencës për periudhën kohore 04.03.2016 e deri me datën 01.11.2018, ku si ekspert është caktuar eksperti financiar Emin Plakaj.

Në ekspertizën financiare të datës 7 prill 2025, konstatohet se duke u mbështetur në të dhënat në dosjen e lëndës dhe atë të siguruar gjatë procesit të ekspertizës, ku ndryshimi nga grada Togër në gradën Rreshter është shuma 66.69euro në muaj. Duke u nisur në llogaritjet si në tabelën nr. 2 diferenca në total për 39 muaj nga data 04.03.2016 e deri me datën 01.11.2018 është në lartësi prej 2,134.08euro, bruto. Të njëjtën shumë duhet të paguaj edhe punëdhënësi prej 106.09 euro. Tatimi në burim i ndalet në pagën e punëmarrësit është në lartësi prej 247.09 euro dhe pas zbritjes së kontributit pensional prej 130.05 euro, dhe tatimit në burim prej 202.74 nga ndryshimi në pagë bruto prej 2,134.⁰⁸€, atëherë kemi diferencën për të ardhura neto prej 1,824.⁶⁴€ për periudhën prej 04.03.2016 e deri me datën 01.11.2018, duke llogaritur për 32 muaj diferencën për gradën Togër dhe asaj Rreshter.

4. Baza ligjore:

Gjykata vlerëson në këtë kontest lidhur me të ardhurat personale nga marrëdhënia e punës duhet të zbatohen dispozitat e Ligjit për Policinë (04/L-076) respektivisht në nenin 47 ku përcaktohet se “4. *Pagat themelore dhe çdo shtesë e autorizuar përcaktohet dhe paguhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin në fuqi dhe me aktet nënligjore. Drejtori i Përgjithshëm, me miratim të ministrit mund të përfshijë në buxhetin vjetor të policisë propozimin për shumat që nevojiten të përdoren për pagimin e çfarëdo pagese shtesë të autorizuar me ligj.*”

Në nenin 32 të Udhëzimit Administrativ për nr. 03/2017 Mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, (E drejta në pagë dhe e shpërblimit), përcaktohet se “*Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin*

e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici.”

Po ashtu, në nenin 39 të të njëjtit Udhëzim Administrativ, (Caktimi i ushtruesit të detyrës), përcaktohet se “ *Kur nevojat e shërbimit kërkojnë plotësimin e një vendi të lirë, atëherë me vendim të drejtorit të përgjithshëm të Policisë, përkohësisht caktohet ushtruesi i detyrës. 2. Ushtruesi i detyrës caktohet për periudhën kohore në kohëzgjatje deri në gjashtë (6) muaj. 3. Nëse për shkaqe objektive, në afatin e përcaktuar në paragrafin paraprak nuk mund të bëhet përzgjedhja e kandidatit, atëherë drejtori i përgjithshëm i Policisë mund t’ia vazhdojë mandatin ushtruesit të detyrës, më së shumti edhe për 3 muaj, ose ta emërojë një ushtrues tjetër edhe për 3 muaj. 4. Në rastet kur ndaj personelit policor zhvillohen hetime penale, caktimi i ushtruesve të detyrës zgjatet deri në përfundimin e procedurës penale.” 5. Përgjegjësit e PK-së duhet të përkujdesen që brenda mundësisë vendet e lira të punës të plotësohen me punonjës të përhershëm sipas procedurës së rregullt të përzgjedhjes. 6. Ushtruesi i detyrës i gëzon të gjitha të drejtat dhe beneficionet që i kanë takuar punonjësit i cili më herët ka qenë në atë pozitë.*

5. Vlerësimi i gjykatës:

Gjykata vlerëson se nuk është kontestues fakti se paditësi ka themeluar marrëdhënie pune tek e paditura dhe sipas akt emërimit i njëjti ka gradën Rreshter. Me datën 03.03.2016 deri më datën 01.11.2018, krahas pozitës së tij si Rreshter, kishte qenë i caktuar edhe në pozitën e Udhëheqësit të ndërrimit në njësinë reaguese, pozitë kjo e cila parashihet me gradën e Togërit. Kontestuese paraqitet të jetë nëse paditësit i takon kompensimi në emër të punës së kryer në pozitën e lartcekur.

Fillimisht, e paditura nëpërmjet përgjigjes në padi, thekson se Komandanti i Policisë së Kosovës nëpërmjet vendimit të Komisionit të Stacionit Policorë në Ferizaj i evidentuar me datën 19.06.2017, kishte bërë “Anulimin e Aprovimit” lidhur me kërkesën për emërimin në pozitën të adresuar nga Drejtoria Rajonale e Policisë me nr. datë 05.06.2017, që nënkupton se veçse kishte një vendim nga ana e strukturave hierarkike të Policisë së Kosovës lidhur me emërimin e paditësit në këtë pozitë në mënyrë të përkohshme, mirëpo i njëjti vendim ishte anuluar e që lidhur me këtë akt administrativ, paditësi kishte ushtruar ankesë por e njëjta i ishte hudhur poshtë si e paraqitur pas afatit të paraparë ligjor.

Andaj, e paditura nëpërmjet përgjigjes në padi (pasi në rigjykim nuk ka marrë pjesë përfaqësuesi i i Avokaturës shtetërore) ka pohuar faktin vendimtar se paditësi me vendim është caktuar për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë e Togërit por që ky vendim më vonë ishte anuluar, por sipas përgjigjes së marrë nga ana e Majorit Q. R. (i cili në vitin 2016 deri në vitin 2019 ishte Komandant i Stacionit Policor në Ferizaj), paditësi kishte qëndruar në këtë pozitë nga data 04.03.2016 e deri me datën 01.06.2019.

Në bazë të Udhëzimit Administrativ për nr. 03/2017 Mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, në 39 par. 6. përcaktohet se “ *Ushtruesi i detyrës i gëzon të gjitha të drejtat dhe beneficionet që i kanë takuar punonjësit i cili më herët ka qenë në atë pozitë.*”

Andaj, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, paditësi kishte qenë i caktuar me vendim nga e paditura për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë si Shef i njësisë reaguese, por që përkundër kryerjes së këtyre detyrave, i njëjti nuk është paguar për shërbimin e tij, meqenëse kishte kryer detyrat e pozitës së Togërit, kurse sipas ekspertizës financiare është vërtetuar fakti se diferenca në mes pagës së Rreshterit dhe të Togërit është shuma mujore prej 66.69€, ndërsa nga data 04.03.2016 e deri me datën 01.11.2018, shuma e përgjithshme e diferencës është 1,824.⁶⁴€

Gjykata vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet e të paditurës se kërkesa e paditësit është e paraqitur jashtë afatit ligjorë, pasi në rastin konkret kemi të bëjmë me kërkesa nga marrëdhënia e punës në para siç e përcakton neni 87 të Ligjit të Punës: “*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*”. e nuk është kërkesë për kthim në vendin e punës në bazë të nenit 80 të të njëjtit ligj, e afati i të cilit është 30 ditë (afat prekluziv). Pra, pretendimi i përfaqësuesit të palës së paditur lidhur me padinë është i pa bazuar pasi padia është e afatshme dhe e paraqitur brenda afatit tre vjeçar siç e cekëm më lartë.

6. Kamatëvonesa;

Lidhur me kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD, si dhe bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.265/2020 të datës 02.12.2020.

7. Shpenzimet e procedurës;

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerrë konform nenit 452 të LPK dhe tarifës zyrtare për përfaqësime dhe atë si në vijim: për përpilimin e padisë në shumë prej 104 euro si dhe për pagesën e taksës gjyqësore në shumë prej 20 euro, për 4 seanca secilën shumën prej 135€, gjithësj 540 euro, për ekspertizën financiare enë vlerë prej 200 euro, respektivisht shumën e tërësishme të shpenzimeve prej 824.⁰⁰ euro.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM- DIVIZONI CIVIL

C.nr.2024:032499, me datën 08 gusht 2025

Gj y q t a r j a,
Kreshnike Zymberi Beqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve pas ditës së pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.